



**REPUBLIKA E KOSOVËS /  
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO**

---

**C.nr.446/14**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Lumni Sallauka, me procesmbajtësen Raxhije Emimi, në kontestin e paditëses S. F. nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson av. H. S. nga Prizreni, kundër të paditurës Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Shefqet Hasimi nga Prishtina, me objekt të padisë kompensimin e të ardhurave personale, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, me datë **11.11.2014** mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET si e bazuar** kërkesëpadia e paditëses S. F. nga Prizreni.

**II. DETYROHET** e paditura Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të të ardhurave personale, për periudhën kohore prej datës 01.09.2007, e deri me datë 31.08.2008, ti paguajë paditëses shumën prej 3.423,99 €, për vendin e punës edukatore në Shkollën Speciale “Nëna Terezë” në Prizren, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

**III. DETYROHET** e paditura Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me seli në Prishtinë, që paditëses t’ia paguajë shpenzimet procedurale në shumë prej 1,082.00 €, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

**A r s y e t i m**

Paditësja S. F., përmes të autorizuarit të saj av. H. S., me datë 07.05.2007, ka parashtruar padi në gjykatë, të cilën e ka precizuar me parashtresën e datës 15.11.2010 dhe në shqyrtimin kryesor të datës 19.12.2012 me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të të ardhurave personale, për periudhën kohore prej datës 01.09.2007, e deri me datë 31.08.2008, ti paguajë paditëses shumën prej 3.423,99 €, për vendin e punës edukatore në Shkollën Speciale “Nëna Terezë” në Prizren, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm, si dhe të paguaj shpenzimet procedurale në shumë prej 1,152.00 € dhe atë për 8 seanca gjyqësore të mbajtura, për përpilimin e padisë dhe kryerje të ekspertizës financiare.

## *1. Juridiksioni dhe kompetenca e gjykatës*

Fillimisht, gjykata shqyrtoi juridiksionin dhe kompetencën e kësaj çështjeje dhe bazuar në nenin 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), por edhe me dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, më saktësisht nenit 79, konstatoi se çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor civil dhe kjo gjykatë është kompetente për të vendosur këtë çështje.

Lidhur me kompetencën lëndore, në bazë nenin 17.2 të LPK-së: *“Vlerësimi i kompetencës bëhet në bazë të thënieve në padi dhe në bazë të fakteve që i ka të njohura gjykata”*. Meqënëse ndodhemi përpara një kontesti me karakter civil që rrjedh nga marrëdhënia e punës, gjykata çmon se është kompetente nga pikëpamja lëndore për shqyrtimin e kësaj çështjeje.

Lidhur me kompetencën territoriale në bazë të nenit 49 të LPK-së: *“Në qoftëse në kontestin nga marrëdhënia e punës paditës është punëtori, për gjykim është kompetente përpos gjykatës së kompetencës së përgjithshme territoriale për të paditurin, edhe gjykata në territorin e së cilës kryhet puna ose është kryer, respektivisht gjykata në territorin e së cilës puna është dashur të kryhet, si dhe gjykata në territorin e së cilës është themeluar marrëdhënia e punës”*. Duke qënë se në bazë të kontratës së punës së paditëses është kontraktuar që puna të kryhet në territorin e Prizrenit, rezultoi se kompetente për shqyrtimin e kësaj çështjeje civile është kjo gjykatë.

Pala paditëse, legjitimohet t'i drejtohet gjykatës me këtë padi pasi pretendon se i janë shkelur të drejtat nga marrëdhënia e punës, dhe kërkon të rivendosë në vend këto të drejta. Pala e paditur ka legjitimitet real pasiv në këtë çështje juridike pasi që ka qënë në raport kontraktual (punëdhënës) me paditësen.

Gjithashtu gjykata, në vështrim të nenit 67 të LPK-së, çmoi se nuk ekzistojnë për të, shkaqe papajtueshmërie, ose përjashtimi nga ky gjykim, fakt ky i pa kundërshtuar dhe nga palët prezent në gjykim.

## *2. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse*

I autorizuari i paditëses gjatë shqyrtimit kryesor ka ngelur pranë pohimeve të padisë dhe kërkesëpadisë së precizuar dhe deklarimeve në shqyrtimet e mbajtura, duke cekur se paditësja ka qënë në marrëdhënie pune tek e paditura, së fundmi me kontratën e punës nr.425/02-1 dt.14.06.2004, në kohë të caktuar dhe atë nga dt.07.06.2004 deri më dt.07.06.2007, në vendin e punës Drejtoreshë në Shkollën Speciale “Nëna Terezë” në Prizren. Me vendimin nr.85/02-5 dt.03.04.2007, kryeinspektori i arsimit i shqipton masën disiplinore suspendim me pagesë, ndërsa me vendimin e komisionit disiplinor të të paditurës nr.441 datë 30 dhjetor 2007 paditëses i ndërprehet marrëdhënia e punës. Me vendimin e komisionit të ankesave të të paditurës Ref: 03/02-/K datë 21.04.2008 ndryshohet vendimi i komisionit disiplinor dhe masa e shqiptuar nga ky komision i zëvendësohet me dënimin ulje e pozitës dhe sitemim në punët përkatëse në përputhje me pregaditjen profesionale që posedon. Si rezultat i këtij vendimi paditësja nga data 21.04.2008 ka filluar të punoj dhe vazhdon të punoj në

Shkollën Speciale “Nëna Terezë” në pozitën e edukatorës. Meqenëse paditëses nuk i janë paguar të ardhurat personale për periudhën 01.09.2007, e deri më 31.08.2008, edhe pse ka qenë obligim i të paditurës ta bëjë një gjë të tillë, ka kërkuar nga gjykata që të aprovojë në tërësi kërkesëpadinë e paditëses dhe ta detyroj të paditurën që t’i kompensojë të ardhurat personale dhe shpenzimet e procedurës, të përshkruara në pikën II dhe III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

I autorizuari i të paditurës në përgjigjen e vet ndaj pohimeve të padisë dhe kërkesë padisë ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes së dhënë në padi, dhe deklarimeve të bëra në shqyrtimet e mbajtura, përmes të cilave e kundërshton në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, duke kërkuar nga gjykata që të zbatojë udhëzimet e dhëna me aktvendimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr.1030/2013, datë 18.04.2014, dhe në fund të merr një aktgjykim të bazuar në ligj. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

### *3. Provat e administruara në shqyrtimin kryesor*

Për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare, gjykata gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin dhe vlerësimin e këtyre provave: ekspertizën financiare të ekspertit Q. S. e dt.01.02.2011, ekspertizën plotësuese financiare të ekspertit të lartcekur e dt.20.11.2012, listën e pagave të buxhetit të konsoliduar të Kosovës, listën e pagave të buxhetit të konsoliduar të Kosovës për pagën e paditëses për muajin korrik 2007, vendimin e Ministrisë së Arsimit nr. 03/02-1/K dt.21.04.2008, kontratën e punës për mësimdhënës nr.2/2008 dt.08.10.2008, vendimin e Ministrisë së Arsimit nr.85/02- dt.03.04.2007, vendimin e KPMK-së nr. A,02,147/2008, vërtetimin e Qendrës Burimore për Arsimin e nxënësve me aftësi të kufizuara “Nëna Terezë” me nr. 070/14, datë 07.07.2014.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, përfshirë këtu edhe udhëzimet e dhëna nga Gjykata e Apelit përmes aktvendimit Ac.nr.1030/2013, datë 18.04.2014 ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është **e bazuar**.

### *4. Faktet*

Me kontratën e punës nr. 425/02-1 e datës 14.06.2004, e paditura Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë lidh kontratë pune me paditësen, për vendin e punës Drejtor në Shkollën Speciale “Nëna Terezë” në Prizren, për periudhën 07.06.2004 deri më 07.06.2007.

Me vendimin nr.85/02-5 datë 03.04.2007, i marr nga kryeinspektori i arsimit, paditësja suspendohet me pagesë deri në përfundim të procedurës disiplinore ndaj saj. Me vendimin e komisionit disiplinor të të paditurës nr. 441 datë 30.12.2007, paditëses i shqiptohet masa disiplinore ndërprerje e marrëdhënies së punës. Me vendimin e komisionit të ankesave të të paditurës Ref: 03/02-1/K datë 21.04.2008, pranohet pjesërisht ankesa e paditëses dhe masa e dënimit e shqiptuar me vendimin e komisionit disiplinor të MASHT-it nr. 441 datë 30 dhjetor 2007, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, i

zëvendësohet me dënimin ulje e pozitës dhe sistemim në punë përkatëse në përputhje me pregaditjen profesionale që posedon paditësja.

Nga vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikqyrës nr. A, 02,147/2008, datë 02.09.2008, aprovohet pjesërisht ankesa e këtu paditëses S. F. dhe anulohet vendimi i Komisionit për ankesa nr.03/02-1/K, i datës 21.04.2008, si dhe vendimi i Komisionit Disiplinor nr. 441, i datës 30.11.2007 dhe lënda kthehet në rishqyrtim.

Me kontratën e punës nr. 2/2008 e datës 09.10.2008, e paditura Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë lidh kontratë pune me paditësen, për vendin e punës edukatore në Shkollën Speciale “Nëna Terezë” në Prizren, për periudhën 01.09.2008 deri më 31.08.2009.

Nga vërtetimi i Shkollës Speciale “Nëna Terezë” nr.103/12 datë 18.06.2012, vërtetohet fakti se paditësja në këtë shkollë ka punuar nga data 15.10.1983 deri më 16.04.2007 (si drejtoreshë në periudhën e fundit), ndërsa nga data 21.04.2008 e tutje vazhdon të punoj si edukatore.

Eksperti financiar Q. S. në ekspertizën e tij fillestare dhe në atë plotësuese të datës 20.11.2012 konstaton se: në bazë të dokumentacionit, si dhe bisedave në prezencë të drejtorit të shkollës B. K. dhe personit zyrtar O. V., me datë 16.11.2012 ka marr dokumentacionin shtesë (kontrata e punës si drejtoreshë dhe edukatore të paditëses, fotokopjen e pagesës së fitimit për muajt kontestues) dhe si rezultat i tyre ka konstatuar se periudha e fitimeve të mbetura është nga data 01.09.2007 deri më 31.08.2008, e sikurse është dhënë në ekspertizën fillestare nga data 01.09.2007 e deri më 30.09.2008. Në bazë të të lartcekurave ka vërtetuar se për periudhën e fitimeve të papaguara nga data 01.09.2007 e deri më 31.08.2008, gjithsejt fitimi neto i papaguar pa valorizim është në shumë prej 2.983,44 €, nga specifikacioni sipas muajve të përshkruar në arsyetimin e pikës 3. Ndërsa në mendimin përfundimtar eksperti cek se shuma e cila ka mbetur pa ju paguar paditëses së bashku me valorizim (kamatë) për periudhën 01.09.2007-31.08.2008 është shuma prej 3.423,99 €. Në këtë ekspertizë eksperti jep detaje rreth metodave që janë përdorur në llogaritjen e të ardhurave personale që i takojnë paditëses.

Nga vërtetimi i Shkollës Speciale “Nëna Terezë” nr.070/14, datë 07.07.2014, ndër të tjera vërtetohet fakti se paditësja S. F. ka marr pagën e muajit gusht 2007 si Drejtoreshë e shkollës në vlerë bruto prej 273 euro. Ndërsa bazuar në listën e pagave prej muajit shtator 2007 e deri në muajin shtator 2008, e njëjta nuk figuron në listën e pagave.

## *5. Ligji i aplikueshëm*

Neni 14 i Ligjit Themelor të Punës i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/27 (i cili ka qenë në fuqi në kohën në të cilën paditësja pretendon se nuk i janë paguar të ardhurat personale), rregullon çështjen e pagave, mënyrën e pagesave, si dhe obligimin e punëdhënësit që për punën e kryer nga ana e punëmarrësit t'i paguajë të ardhurat personale, ndërsa Ligji i Punës që është në fuqi çështjen e pagave e rregullon në nenin 55 të tij.

## *6. Vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës*

Pas analizimit dhe vlerësimit të gjendjes faktike të cilën e kemi cekur më lartë, gjykara erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar në ligj dhe fakte.

Gjykatës i rezultoi se në këtë çështje juridike kontestimore nuk ishin kontestuese këto fakte: fakti se paditësja ka qenë dhe vazhdon të jetë në marrëdhënie pune tek e paditura (shkolla speciale “Nëna Terezë”) paraprakisht në pozitën drejtoreshë për periudhën 07.06.2004 deri më 03.04.2007, datë kur edhe suspendohet me pagesë nga kryeinspektori i arsimit, fakti se me vendimin e komisionit të ankesave Ref: 03/02-1/K paditëses i ulet pozita nga drejtor në edukatore pranë shkollës speciale “Nëna Terezë” ku edhe vazhdon të punoj. Gjithashtu nuk ishte kontestues fakti se me vendimin i Këshillit të Pavarur Mbikqyrës nr. A, 02,147/2008, datë 02.09.2008, aprovohet pjesërisht ankesa e këtu paditëses S. F. dhe anulohet vendimi i Komisionit për ankesa nr.03/02-1/K, i datës 21.04.2008, si dhe vendimi i Komisionit Disiplinor nr. 441, i datës 30.11.2007 dhe lënda kthehet në rishqyrtim. Mirëpo, organet e të paditurës nuk kanë vepruar sipas vendimit të KPMK-së, por paditëses i ofrojnë kontratën e punës për vendin e punës edukatore, e cila edhe e ka pranuar dhe që nga ajo periudhë e deri më tani e njëjta punon në këtë insitucion dhe në atë pozitë.

Kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqese ishte fakti se e paditura a i ka paguar të gjitha të ardhurat personale paditëses, më saktësisht a është paguar kjo e fundit për periudhën kontestuese nga data 01.09.2007 deri më datë 31.08.2008.

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave të administruara, gjykata erdhi në përfundim se paditëses nuk i janë paguar të ardhurat personale për periudhën e lartcekur, fakt ky që vërtetohet nga ekspertiza e ekspertit financiar, të cilës ekspertizë gjykata ja fali besimin e plotë, pasi që është bazuar në dokumentacionin e siguruar nga e paditura (të cilat eksperti i ka specifikuar në ekspertizën e tij). Faktin se paditësës asnjëherë nuk i është shkëputur marrëdhënia e punës, gjykata e vërtetoi nga vërtetimi i Shkollës Speciale “Nëna Terezë” nr.103/12 datë 18.06.2012, vendimi i kryeinspektorit të arsimit nr.85/02-5 datë 03.04.2007 me të cilin paditësja është suspenduar me pagesë, ndërsa me vendimin e komisionit të ankesave të të paditurës Ref: 03/02-1/K datë 21.04.2008, pranohet pjesërisht ankesa e paditëses dhe masa e dënimit e shqiptuar me vendimin e komisionit disiplinor të MASHT-it nr. 441 datë 30 dhjetor 2007, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, i zëvendësohet me dënimin ulje e pozitës dhe sistemim në punë përkatëse në përputhje me pregaditjen profesionale që posedon paditësja. Këtë fakt gjykata e vërtetoi edhe nga vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikqyrës nr. A, 02,147/2008, datë 02.09.2008, me të cilin janë anuluar vendimet e të paditurës. Ndërsa, pas vendimit të KPMK-së, e paditura i ofron kontratën e punës paditëses ku e njëjta pranon të sistemohet në vendin e punës edukatore. Si rrjedhojë siç e kemi cekur më lartë rezultoi se paditësja nuk ka patur asnjëherë shkëputje të marrëdhënies së punës, por nga data 03.04.2007 paditësja suspendohet me pagesë, ndërsa nga data 21.04.2008, i ulet pozita nga drejtoreshë në edukatore, ndërsa përfundimisht pas vendimit të KPMK-së paditësja sistemohet në vendin e punës edukatore ku vazhdon edhe sot.

Gjykata nuk e pranoi pretendimin e palës së paditur se kërkesëpadia e paditëses nuk qëndron, pasi që e njëjta e ka tërhequr pjesën e kërkesëpadisë që ka të bëjë me kthimin në vendin e punës, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses për kompensimin e të ardhurave personale është e lidhur objektivisht me kërkesën e parë, për faktin se paditëses në bazë të të lartcekurave asnjëherë nuk i është ndërprerë marrëdhënia e punës, si dhe e njëjta ka të drejtë ligjore që të kërkojë kompensimin e të ardhurave personale për punët e kryera dhe në të njëjtën kohë është obligim i palës së paditur si punëdhënës që ta kryej obligimin të cilin e ka në raport me paditësen, ndërsa bazuar në nenin 257.2 të LPK-së nuk mund të quhet edhe padi e ndryshuar, pasi në rastin konkret paditësja e ka zvogëluar kërkesëpadinë.

Sa i përket çështjes se a është paguar ose jo për periudhën kontestuese paditësja nga ana e të paditurës, gjykata në shqyrtimin e mbajtur me datë 10.05.2011 e ka obliguar të autorizuarin e të paditurës që gjykatës ti dorëzojë listën e pagave (të buxhetit të konsoliduar të Kosovës) të punëtoreshave të Shkollës Speciale “Nëna Terezë” për periudhën kontestuese 01.09.2007-31.08.2008, e cila do të vërtetonte faktin se paditëses a i janë paguar të ardhurat personale për këtë periudhë (kjo për faktin se puntorët e Shkollës Speciale “Nëna Terezë” marrin paga nga buxheti i Kosovës dhe lehtësisht mund të vërtetohet se kush paguhet nga ky buxhet). Mirëpo këtë obligim e paditura nuk e ka përmbushur dhe nuk i ka dorëzuar gjykatës këtë provë materiale e cila do të provonte eventualisht pretendimin e të paditurës se paditësja është paguar për këtë periudhë, pra në rastin konkret gjykata ka aplikuar rregullat mbi barrën e provës të parapara me nenin 322.3 të LPK-së. Faktin e mos pagesës së të ardhurave personale paditëses për periudhën kontestuese, gjykata e vërtetoi edhe nga ekspertiza e ekspertit financiar Qemal Smajli, i cili këtë ekspertizë siç e kemi cekur edhe më lartë e ka bazuar në dokumentacionin e siguruar në Shkollën Speciale “Nëna Terezë” dhe nga informacionet e marra nga përgjegjësit e kësaj shkolle. Përfundimisht me vërtetimin Shkollës Speciale “Nëna Terezë” nr.070/14, datë 07.07.2014, gjykata vërtetoi faktin se paditësja S. F. ka marr pagën e muajit gusht 2007 si Drejtoreshë e shkollës në vlerë bruto prej 273 euro, ndërsa bazuar në listën e pagave prej muajit shtator 2007 e deri në muajin shtator 2008, e njëjta nuk figuron në listën e pagave, që do të thotë se e njëjta nuk ka marrë pagë për periudhën kontestuese.

Nga të lartcekurat gjykata erdhi në përfundim se e paditura ka për obligim që paditëses ti paguaj shumën e cekur në pikën **II** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për të ardhurat e papaguara personale për periudhën 01.09.2007-31.08.2008, për vendin e punës edukatore, ashtu siç është specifikuar në ekspertizën plotësuese të ekspertit financiar Q. S. të datës 20.11.2012.

Gjykata ka bërë administrimin dhe vlerësimin edhe të provave të tjera, të cilat u elaboruan më lartë, mirëpo vlerësoi se të njëjtat nuk janë relevante dhe janë pa ndikim në zgjidhjen e kësaj çështje juridike.

Vendimin për shpenzimet procedurale gjykata e mori konform nenit 452.1 të LPK-së dhe TA-së, ku e obligoi të paditurën që ti paguajë shpenzimet procedurale në shumë prej 1.082.00 € dhe atë 800 € për tetë përfaqësime (dy përfaqësime të mbajtura pas kthimit të lëndës në rigjykim), 72 € për përpilim të padisë dhe 210 € për ekspertizë financiare (përfshirë atë plotësuese). Ndërsa gjykata refuzoi kërkesën e të autorizuarit të paditësit që të kompensohen edhe

shpenzimet për seanca të cilat nuk janë mbajtur, pasi konsideroi se shuma e shpenzimeve të cekur në pikën III të dispozitivit të aktgjykimi është reale dhe e mjaftueshme.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 143 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**C.nr.446/14, datë 11.11.2014**

**Procesmbajtësja,**  
Raxhije Emini

**Gjyqtari,**  
Lumni Sallauka

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.